



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN  
KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Laç, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**NJOFTIMI I KONTRATËS**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri	Bashkia Kurbin
Adresa	Lagjia Nr.3, Laç
Tel/Fax	++ 35553 22 270
E-mail	bashkiakurbin@gmail.com
Faqja në Internet	_____
Personi Pergjegjes	Pjeter Bushi
Nr. Cel.	0682205942

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”** Shërbime “Prokurim me mjete elektronike”

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** “Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njësitë Administrative Milot dhe Fushë-Kuqe”.

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-90275-03-17-2021**

**5. Fondi limit: 78,969,934** (shtatëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 5 vite kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

**Sqarojmë se:** Autoriteti Kontraktor ka vendosur kryerjen me afat 5 vjecar të shërbimit me objekt: **“Pastrimi, grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane dhe të ngurta, Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe e varrezave për Njësitë Administrative Milot dhe Fushë-Kuqe”**, bazuar në pikën 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 21.06.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave” ku thuhet shprehimisht se: 2. *“Procedurat e dhënies në sipërmarrje të këtyre shërbimeve do të jenë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.467, datë 17.08.1993 ”Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore:*

*3. Organet e pushtetit lokal bëjnë ndarjen e territorit që kanë në administrim në zona për pastrimin e rrugëve dhe grumbullimin e mbeturinave. Organet e pushtetit lokal organizojnë*

*prokurime të veçanta për sipërmarrjen e shërbimeve për secilën zonë. Kontratat do të lidhen në bazë të procedurave të prokurimit me kontraktues të kualifikuar dhe do të jenë me afat 3 deri 5 vjet. Si dhe bazuar në pikën 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.473, datë 03.10.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të funeralit, mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbërta, dekorit dhe varrezave publike e të dëshmoreve”, ku thuhet shprehimisht se: “Procedurat e dhënies në sipërmarrje të këtyre shërbimeve të jenë ato të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.467, datë 17.08.1993 ”Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore: me afate kohore deri në 5 vjet”.*

Bazuar sa më sipër Këshilli Bashkiak Kurbin me Vendimin Nr.153, datë 14.12.2020 “Për miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe inerteve, të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe e varrezave me afat 5-vjeçar për Njësitë Administrative Milot dhe Fushe-Kuqe”, ka vendosur:

1. Miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe inerteve, të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe të varrezave për Njësitë Administrative Milot dhe Fushe-Kuqe.
2. Miratimin e kohëzgjatjes së këtyre shërbimeve për një periudhë 5-vjeçare.

Vendim i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhe me shkresën Nr.1109/9 prot, datë 24.12.2020 “Konfirmim vendimi”.

Gjithashtu sqarojmë se bazuar në nenin 76, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor argumenton se shërbimi i pastrimit grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe inerteve është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor dhe ku financimi i saj është i garantuar.

**7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** Datë **13.04.2021** (dd/mm/vvvv) ora **11.00**, Vendi: Në faqen zyrtare të APP-së: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** Datë **13.04.2021** (dd/mm/vvvv) ora **11.00**, Vendi: Në faqen zyrtare të APP-së: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Titullari i Autoritetit Kontraktor  
Majlinda CARA**